

**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"DETAIXI PRODUCTIONS" Sh.P.K**

Sipas ligjit Nr.° 9901 Datë 14.04.2008 "Për Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", dhe në përputhje me Ligjet që operojne në Republikën e Shqipërisë, themelohet shoqeria "DETAIXI PRODUCTIONS" nga palët e mëposhtme:

**Alesia Sallaku**, shtetase Shqiptare e lindur më 29/03/1998 në Shkodër identifikuar me kartë identiteti nr personal J85329074J, e vlefshme deri më 13/04/2026, madhor dhe me pergjegjësi të plote për të vepruar;

**Xhoi Alliu**, shtetase shqiptare, lindur në Gjirokaster më 29/04/1998, identifikuar me kartë identiteti nr personal J85429040F, e vlefshme deri më 14/09/2025, madhor dhe me përgjegjësi të plotë për të vepruar;

Sot më 3.11.2020, palët e mësipërme, bien dakort për themelimin e shoqërisë, kushtet në vijim:

***Neni 1***

***Emertimi i shoqerise***

Shoqëria do të mbajë emrin "DETAIXI PRODUCTIONS" Sh.P.K.

***Neni 2***

***Forma Ligjore e Shoqërisë***

**2.1** Shoqëria do të ketë formën e saj Ligjore, "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" sipas Ligjit Nr. 9901 Datë 14.14.2008 "Për Tregetaret dhe Shoqëritë Tregetare" bashkë me ndryshimet përkatëse.

**2.2** Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore me vendim të ortakëve themelues.

***Neni 3***

***Afati***

**3.1** Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor deri ne 31.12.2022, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likuidimi me vendim të Asamblese së Ortakeve, si dhe në rastet e tjera të parashikuara në ligj edhe perpara ketij afati, sikurse edhe zgjatja e afatit po ne te njejten menyre.

***Neni 4***

***Selia dhe Territori***

**4.1** Selia e shoqërisë është në adresën Rrugën "Panajot Pano", Pallati 6 Apt. 53, Tiranë, Kashar, Shqipëri.

**4.2** Shoqëria mund të krijojë zyra ose përfaqësi të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Zyrat, filialet ose përfaqesite e shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të zhvillojnë veprimtarine e tyre në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

## ***Neni 5***

### ***Objekti***

#### **5.1 Shoqëria ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:**

- Krijimin e reklamave vizuale te formave te ndryshme (video, foto, grafika vizuale etj.).
- Krijimin e teksteve te formave te ndryshme (artikuj, skenare etj.).
- Krijimin e audiove te formave te ndryshme (muzike, efekte tingelluese, voiceovers etj.).
- Krijimin e nje imazhi/brandi.
- Krijimin e strategjive te fushatave te marketingut.
- Menaxhimin e rrjeteve sociale.
- Konsulence te ndryshme ne fushen e menaxhimit dhe marketingut.
- Koncept brendimi per te trete dhe per vete.
- Krijim markash, logosh dhe tregtim i tyre.
- Trajnime te ndryshme dhe ekspertiza kombetare dhe nderkombetare ne fushen e marketingut dhe brendimit te produkteve apo sherbimeve apo te tjera.
- Sherbime telefonie dhe asistence per pale te treta.
- Sherbime te organizimit te panairove dhe eventeve te promovimit dhe nxitjes se siper marrjes.
- Sherbime te marrje dhe dhenie me qera te ambjenteve per organizim eventesh.
- Sherbime te montimit dhe cmintimit te stendave apo te strukturave te levizshme ne sherbim te eventeve te perkohshme apo te qendrueshem.
- Organizim festash, ditelindjesh dhe te tjera per individe, sub jekte dhe te tjera.
- Projekt design i arredimeve interior dhe outdoor.
- Marrje dhe dhenie me qera te hapsirave publicitare digjitale apo fizike, ne media apo billboardet etj.
- Të tjera në funksion te realizimit te objektit te shoqerise apo të ngjashme me te.

**5.2** Për të arritur qëllimin e shoqërisë dhe pa e zgjeruar atë, mund të kryejë të gjitha veprimet për pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe cdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm, ose dhënie me qira të pjesëve të shoqërisë, qëllimi i të cilave është i ngjashëm ose i njëjtë, përfshirë këtu edhe marrjen dhe dhenien e perfaqesive te ndryshme kombetare dhe nderkombetare.

## ***Neni 6***

### ***Kapitali***

#### **6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 10.000 (dhjetë mijë) Lek i përbërë si vijon:**

Alesia Sallaku zotëruese e një kuote të barabartë me 50% te kapitalit themelues te shoqërisë, ekuivalente në vlerë nominale me 5.000 Lek.

Xhoi Alliu zotëruese e një kuote të barabartë me 50% të kapitalit themelues të shoqërisë, ekuivalente në vlerë nominale me 5.000 Lek.

Kapitali themeltar, eshte per tu derdhur brenda vitit fiskal ne shoqeri. Kapitali i shoqerise, mund te zvogelohet apo te rritet ne cdo kohe me vendim te ortakeve themelues.

## ***Neni 7***

### ***Organet Drejtuese dhe vendimarrëse***

**7.1** Organi vendimarrës i shoqërisë është asamblea e ortakëve themelues të shoqërisë, e cila drejton aktivitetin e shoqërisë ndërmjet vendimeve të tij.

- a. Përkufizimi i politikave të kompanisë
- b. Ndryshon dhe/ose modifikon statutin e shoqërisë



- c. Emëron dhe shkarkon administratores
- d. Emëron dhe shkarkon auditores
- f. Përcakton nxitjen e personave në paragrafin C dhe D.
- e. Ndryshon selinë
- f. Ndryshon emrin e shoqërisë
- g. Rikapitalizon shoqërinë, duke rritur dhe/ose zvogëluar shoqërinë
- k. Ndarjen ose anulimin e kuotës
- h. Riorganizimin ose prishjen e shoqërisë
- i. Miraton rregulloren procedurale për mbledhjen e mbledhjes tye ortakëve të shoqërisë.
- j. Të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti

### ***Neni 8***

#### ***Transferimi i pjesëve të Kapitalit***

**8.1** Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen lirish mes ortakëve të shoqërisë. Kapitali themeltar i shoqërisë ose pjesë të tij mund të transferohen tek persona të tretë vetëm pasi ortakët e shoqërisë në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar zyrtarisht kanë refuzuar ushtrimin e të drejtës së parablerjes.

**8.2** Transferimi i kapitalit themeltar të shoqërisë ose i pjesëve të tij tek persona të tretë behet vetëm në këtë mënyrë:

- Oferta për shitje u drejtohet të gjithë ortakëve me shkrim;
- Oferta duhet të përcaktojë numrin e kuotave që shiten dhe çmimin e tyre; Nëse ortakët e shoqërisë brenda 3 (tre) muaj nga oferta me shkrim nuk pranojnë blerjen e kuotave të ofruara me çmimin e përcaktuar, atëherë konsiderohet se ata lejojnë shitblerjen tek të tretët.

### ***Neni 9***

#### ***Organet Drejtuese***

**9.1** Shoqëria mund të emerojë më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar Administratorin e shoqërisë "DETAIXI PRODUCTIONS" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numer.

**9.2** Përveç organeve të parashikuara më sipër Asambleja e Ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre, sikurse është bordi i administratorëve, në rast se emrohen më shumë se një administrator.

**9.3** Administrator i shoqërisë është emëruar Alesia Sallaku, shtetase Shqiptare lindur në Shkodër më 29/03/1998, identifikuar me kartë identiteti nr J85329074J, madhore dhe me përgjegjësi të plotë për të vepruar, për 2 vjet me të drejtë rinovimi automatikisht, në rast se nuk është komunikuar vendimi i ortakëve themelues, të pakten 15 dite para datës së përfundimit të këtij afati.

### ***Neni 10***

#### ***Vendimet e Asamblesë së Ortakëve***

**10.1** Asambleja e Ortakëve vendos për çështjet që ligji apo ky statut i rezervon këtij organi, si dhe për çështjet të cilat, organi administrativ kërkon mendimin apo miratimin e ortakëve.

**10.2** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 50 % të kuotave të kapitalit themeltar. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas ligjit mbi shoqëritë tregtare, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më

shume se 75 % te numrit total te kuotave te kapitalit themeltar jane te pranishem dhe vendosin me voten e  $\frac{3}{4}$  (tre te katertave).

#### ***Neni 11***

##### ***Ushtrimi Financiar***

11.1 Viti financiar i shoqërisë është nga 1 Janari dhe mbaron më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë i veprimtarisë së shoqërisë do të llogaritet nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe do përfundojë më 31 dhjetor.

#### ***Neni 12***

##### ***Të ardhurat, Dividentët***

12.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e aktivitetit të shoqërisë. Fitimi pas përfundimit të vitit financiar dhe pas pagimit të tatimit, mund të shpërndahet tek ortakët me vendim të asamblese së ortakëve themelues të shoqërisë.

#### ***Neni 13***

##### ***Shpërndarja dhe Likuidimi***

13.1 Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet për sa vijon:

- a. Fundi i kohëzgjatjes së aktivitetit të parashikuar në statut;
- b. Me vendimin e asamblese së ortakëve themelues të shoqërisë;
- c. Hapja e një procedure falimentimi;
- d. Me vendimin e gjyqtarit;

13.2 Likuiduesi, raporton për statusin e aktiveve dhe detyrimeve të kompanisë në operacionet e mëtejshme të shlyerjes dhe kohën e nevojshme për mbylljen e procesit. Në fund të këtij procesi, ortakët, do të informohet për balancën përfundimtare dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

#### ***Neni 14***

##### ***Klauzola mbyllëse***

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, nëse nuk zgjidhen në mënyrë miqësore, palët drejtohen organeve kompetente, Ndermjetesve ligjor, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përveç rasteve kur kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas ligjit është Sistemi Gjyqësor Shqiptar.

#### **ORTAKET E SHOQERISE** (Emer Mbiemer / Nenshkrimi)

Xhavit Alliu

Alexia Sallaku



